



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 5382/prot.
13

Pogradec, më 27.122024

VENDIM

Nr. 144, DATË 27/12 /2024

PËR

MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PËR NDERTIM
PARK FOTOVOLTAIK (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET
PERKATESE), NË PASURITE ME SIPËRFAQE TOTALE 47.4663 (DYZET
E SHTATE PRESJE KATERMIJE E GJASHTEQIND E
GJASHTEDHJETE E TRE) HA.

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish-komunave /Bashkive", te ndryshuar me vendimin nr 398 date 13.05.2020, Udhezimit Nr.13, datë 26.04.2018 "Per zbatimin e vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedurës dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim, për ndërtim park fotovoltai (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatese), në pasuritë e ndodhura në fshatin Homezh Njësinë Administrative Proptisht, fshatin Udenisht Njësinë Administrative Udenisht Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Z.K	Nr Pasur	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kerkeses

¹Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

1	1959	486	Homezh, Proptisht	230788	Park Fotovoltaik
2	3665	811	Udënisht, Udënisht	243875	Park Fotovoltaik
			SHUMA	474663	

2. Afati i dhënies me qera te jetë deri ne 10 vite, me te drejte ripertëritje, sipas periudhes te përcaktuar ne projekt, dhe studimin e fizibilitetit të dorëzuar nga kërkuesit në konkurim.

2. Ky proces te kryhet sipas percaktimeve të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e kriterëve, te procedurës dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shtetërore", te ndryshuar.

3. Tarifat për dhënie në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas pika 8 e shtojces nr 1 te Vendimit të Keshillit te Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

4. Shoqëritë kërkuese të përdorin pasuritë e mësipërme për ushtrimin e aktivitetit të saj sipas objketit të parashikuar ne kërkesën e tyre dhe studimin e fizibilitetit te paraqitur per marrjen në përdorim të pasurive.

5. Kontrata bashkëngjitur projekt vendimit, eshte hartuar ne zbatim te Vendimit Nr. 421, datë 12.6.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, ne kushtet e saj do percaktohet edhe se te gjithë blektoret e regjistruar dhe duan te perdorin keto siperfaqe kullosore, do te lejohen te perdoren nga ata pa shperblim dhe duke mos u sjelle asnje pengese ne perdorimin e saj.

6. Të Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec për lidhjen e kontratës, mbas përfundimit të procedurave konkurruese.

7. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec.

8. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOELI



1. Miratuar me 18 vota

2. Vota Pro 18

3. Vota Kundër 4

4. Vota Abstenim 1

5. Zbardhur më date 27.12.2024